



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Termat e referencës

Ekspert/e Trajnere për Trajnime në Fushën e avokimit-lobimit dhe shkrimit Strategjisë së Grupit Avokues të grave

Projekti: "Fuqizimi ekonomik dhe politikë i grave në komunën e Klinës "

Zbatuar nga: OJQ ZANA Klinë

Mbështetur nga: Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK)

Financuar nga: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Informata të përgjithshme

OJQ Zana është themeluar në vitin 2002. OJQ ZANA është një organizatë jofitimprurëse, jopartiake që synon të forcojë dhe promovojë një qytetari aktive; përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike. Zana gjithashtu synon të ndikojë në strukturat vendimmarrëse përmes lobimit dhe avokimit, për të ngritur çështje që janë në interes të qytetarëve. OJQ Zana angazhohet për të rritur transparencën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e zyrtarëve politikë dhe publikë ndaj qytetarëve.

OJQ ZANA Klinë, është duke zbatuar projektin "Fuqizimi ekonomik dhe politikë i grave në komunën e Klinës" të mbështetur FGK i RrGK me financim nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti, OJQ ZANA shpall konkurs për trajner/e –ekspert/e në Fushën e **Fushën e avokimit-lobimit dhe shkrimit Strategjisë së Grupit Avokues të grave**

Përgjegjësitë

Ekspteri/ja do të angazhohet maksimumi 10 ditë, gjatë periudhës qershor-korrik 2022.

Ekspteri/ja, në konsultim të ngushtë me OJQ ZANA, do të zhvillojë dy sesione ditore trajnimi dhe raportimit si dhe shkrimin e Strategjisë së Grupit Avokues të Grave në Klinë. Disa nga detyrat kryesore përfshijnë:

- Hartimi i modulit të trajnimit dhe mbajtja e trajnimit për avokim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje
- Përgatitja e agjendës dhe materialeve dhe facilitimi i punëtorisë për hartimin e strategjisë dhe planit të punës
- Përpilimi i strategjisë dhe planit të punës

Mbështetur nga:



Zbatuar





Kualifikimet e Ekspertit/es
Financuar nga
Bashkimi Evropian

- Të ketë të paktën tetë vite përvojë të punës me sektorin joqeveritar. Puna me organizatat e grave është përparësi
- Të ketë të paktën pesë vite përvojë në fushën e trajnimeve, me theks të veçantë në avokim dhe pjesëmarrje të publikut në proceset vendimmarrëse
- Të ketë përvojë në hartimin e strategjive, me theks të veçantë për organizata jo qeveritare
- Të ketë përvojë në hartimin e planit të punës

Dorëzimi i ofertave

Kandidatët/et e kualifikuar/a duhet të dërgojnë pakon e aplikimit duke përfshirë:

- CV-në;
- Letrën e motivimit që shpjegon kualifikimet dhe kapacitetet për realizimin e këtyre detyrave;
- Një përshkrim të shkurtër të qasjes së propozuar ndaj detyrave të renditura më lart (jo më shumë se një faqe);
- Tarifën ditore të propozuar nga eksperti/ja, në përputhje me tarifën paraprake të verifikueshme në mënyrë të pavarur për punë të ngjashme të kryera nga eksperti/ekspertja.

Ekspertët/et e interesuar/a dhe të kualifikuar/a duhet të kenë parasysh se OJQ ZANA Klinë është një organizatë jofitimprurëse që kërkon oferta në përputhje me tarifën ditore vendore.

Ju lutemi, dokumentet e kërkuara ti dorëzoni deri më 03 qershor 2022, në orën 17:00 në e-mailin info@ngo-zana.org duke shkruar në subjekt "Ekspert/e për trajnime".

Mbështetur nga:

nga:



Zbatuar

